



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE**

**VENDIM**

**Nr. 8 / 26, datë 30 / 10 / 2023**

**PËR MOSPRANIM TË KËRKESËS PËR PËRFITIMIN E STATUSIT “INVESTIM/  
INVESTITOR STRATEGJIK PROCEDURË E ASISTUAR”  
PËR PROJEKTIN E INVESTIMIT “IMPIANT FOTOVOLTAIK ME FUQI  
70MWp”, BASHKIA POGRADEC  
ME SUBJEKT APLIKUES SHOQËRINË “DH SOLAR PARK,  
ME NUIS/NIPT: M21809033P”**

Në mbështetje të neneve 9, 13, dhe 17 pika 5 të Ligjit Nr. 55/2015, “Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë”, Kreu I, pika 3/a të VKM Nr. 1023, datë 16.12.2015 “Për Nënsektorët Strategjikë dhe Zonat me Përparësi Zhvillimi” dhe Kreut II, pika 8, 10 e VKM Nr. 1026, datë 16.12.2015 “Për vlerësimin e dokumentacionit të investimeve strategjike”, Komiteti i Investimeve Strategjike vlerësoi se:

- Projekti i investimit propozon zhvillimin e një parku fotovoltaik me fuqi prodhuese deri në 70 MWp. Ndërtimi i impiantit do të shtrihet me një kohëzgjatje prej 5 vitesh, dhe fazat e zhvillimit do të jenë 15/50 MWp, 25/50 MWp, 35/50 MWp dhe 50/50 MWp.
- Vlera e investimit për projektin e propozuar parashikohet të jetë 31,000,000 (tridhjetë e një milion) Euro.
- Projekti do të realizohet në një sipërfaqe totale prej 139.4 ha, në ZK 2420, Njësia Administrative Cerravës dhe Buçimas, Bashkia Pogradec, sipërfaqe e cila rezulton në pronësi shtetërore.

Në përfundim, pasi u njoh me gjithë dokumentacionin e nevojshëm,

**KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE**  
**VENDOSI:**

1. Mospranimin e kërkesës për përfshirjen e projektit investues “Impiant Fotovoltaik me Fuqi 70MWp”, Bashkia Pogradec, me subjekt investues shoqërinë “DH Solar Park”

shpk, me NUIS/NIPT: M21809033P në procedurën e asistuar dhe mbështetjen që ofron ky status.

2. Zona e projektit me sipërfaqe prej 139.4 ha nuk ka një regjistrim fillestar në kadastër, mosregjistrim i cili pengon marrjen e veprimeve të mëtejshme ligjore nga ana e institucioneve.
3. Projekti i propozuar është në mospërputhje me Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Pogradec.
4. Vendimi i Komitetit të Investimeve Strategjike publikohet dhe regjistrohet në Regjistrin e Investimeve Strategjike dhe i njoftohet kërkuarit nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, në rolin e saj të Sekretariatit të Komitetit të Investimeve Strategjike.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE**

**KRYEMINISTËR**

**EDI RAMA**